



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-9340 dt. 21. 02. 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **16.02.2023**, ora 08:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale. Mungoi: Hamit Kastrati.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Znj Manushaqe Mulaku, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Agnesë Kastrati-Bucolli e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 25.01.2022.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.
4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Glllogocit.
5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.
6. Plani i Veprimtimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.
7. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.
8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.
9. Plani i punës për vitin 2023, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan unanimisht rendin e dites.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- sa i përket pikës së parë të rendit të ditës vendimin e kemi marrë nga KQZ-ja dhe do të vazhdojmë me procedurë

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur Të dt. 18.01.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.**

Hamit Haxhiu, keni pas material shtesë për këtë pike të rendit të ditës, me shiku se çka do të bëhet me miratimin e planit?

Lumnije Krapit- Drjtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjente, sa i përket këtij plani është një draft dokument i cili ka kaluar në për procedura të dëgjimeve buxhetore, materialin e keni në email. Është një draft dokument i cili miratohet për pesë vite e kemi 2023-2027, janë përshkruar gjitha procedurat, është hartuar në bazë të planit strategjik të menaxhimit të mbeturinave të nivelit qendror në bashkëpunim me GIZ-in dhe Ministrinë e Planifikimit Hapësinor.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Glogocit.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.**

Meqë nuk pati diskutime, kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.**

Meqë nuk pati diskutime, kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.**

Flutura Avdiu-Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, para jush e keni propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Glllogocit, Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glllogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022 është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale.

Bazuar në nenin 7, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, propozohet të miratohet vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc, dhe pas përfundimit të dërgohet në Kuvendin e Komunës së Glllogocit për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.**

Flutura Avdiu-Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, nenin 39 të Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për ndërtimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka propozuar hartimin e Rregullores për Bonuset e Zonimit në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2022-2030 në territorin e komunës, si dhe është formuar grupi punues në të cilën janë caktuar detyrat dhe përgjegjësitë për hartimin dhe finalizimin e Rregullores komunale për bonuset e zonimit.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nentë të rendit të ditës: **9. Plani i punës për vitin 2023, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**


Laureta Thaqi- Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme, Këshilli për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012, për këshillat komunal për siguri në bashkësi. Sipas këtij udhëzimi puna e KKSB-së duhet të bazohet gjithmonë në dispozitat që rregullojnë e funksionit si një organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Ky plan përcakton disa nga objektivat dhe aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit 2023, gjithmonë me synimin që shqetësimet e qytetareve që adresohen të zgjidhen bashkë me përfaqësuesit insututicional, organet e sigurisë OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10 Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 08:45 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari